



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-14-0375-A0001

Në ankesën e:

Ankuesit A0001-Agjencionit Kosovar të Privatizimit(AKP-së), rruga “Agim Ramadani” nr.23 Prishtinë.

Kundër ankuesve në shkallë të parë:

1. C0002-3 -R R
2. C0002-4-D S
3. C0002-7- D K
4. C0002-9- S (Z), S
5. C0003- Lj J
6. C0004- M (S) J

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur sipas kërkesës së përfaqësuesit të paditëses Snezhana (Zivko) Sedlareviç (C0002-9), pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet kërkesa e paditëses për korrigjimin e Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit AC-I.-14-0357-A0001 të datës 04 tetor 2019 lidhur me ankuesen në Shkallë të parë, S Zh S(C-0002-9).

A r s y e t i m

Më 05 janar 2022, përfaqësuesi me prokurë i paditëses C002-9 S (Zh) S ka parashtruar një kërkesë për korrigjim të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I.-14-0357-A0001 të datës 04 tetor

2019 lidhur me këtë ankuesë. Sipas përfaqësuesit të saj, ekzistojnë dy paditëse me emër dhe mbiemër të njëjtë, andaj e ka të pa qartë se cila është në listën e 20 përqindshit.

Në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I.-14-0357-A0001 të datës 04 tetor 2019, lidhur me ankuesen në Shkallë të parë, S Zh S (C-0002-9) ishte bërë një lëshim teknik, sepse në dy pikat e dispozitivit ishte emri i kësaj ankuese. Një një pikë ajo mbetej në listë, në pikën tjetër hiqej nga lista, andaj me kërkesë të AKP-së për sqarimin e statusit të kësaj punëtoreje pas marrjes së këtij aktgjykimi, Kolegji i Apelit më 29 korrik 2021 me Aktvendimin korrigjues, e ka bërë korrigjimin e këtij aktgjykimi dhe ky aktvendim korrigjues është pranuar nga avokati i paditëses më 04 gusht 2021.

Është e qartë se paditësja S (Zh) S kishte mbetur në listën përfundimtare, sepse ajo ishte pranuar edhe nga Shkalla e parë e DHPGJSK-së.

Sa i përket paditëses tjetër që pretendon avokati se është me emër dhe mbiemër të njëjtë, S (B) S, kjo më nuk është çështje gjyqësore, sepse ankesa e saj ishte refuzuar nga Shkalla e parë dhe e njëjta nuk ishte ankuar dhe nuk ishte palë në fazën e ankesës para Kolegjit të Apelit.

Për këto arsye të dhëna si më lartë, kërkesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar për arsyet e dhëna si më lartë.

Ky Aktvendim bashkë me Aktvendimin korrigjues të datës 29 korrik 2021, t'i dërgohet përfaqësuesit të paditëses.

Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues _____

